




KOMUNA E OBILIQIT-OPSTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. X-522
Br.

Data 21.06.2019
Datum

OBILIC-OBILIC



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republik of Kosova
Komuna e Obiliqit/Opstina Obilic/Municipality of Obilic

Drejtoria e Arsimit

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës ,nr.03/L-032 , Udhëzimin Administrativ të MASHT-it, me nr. 22/2013,dhe kërkesën nr.-X- 419, të datës 20.06.2019, Drejtoria për Arsim, më 24.06.2019, shpall :

K O N K U R S

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në gjimnaz dhe shkollën profesionale për vitin shkollor 2019-2020,afati i parë

1.Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë në gjimnaz dhe shkollën profesionale për vitin shkollor 2019-2020, mund të konkurrojnë kandidatët , të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Republikës së Kosovës , obligohen ta bëjnë nostifikimin e dëftesave në MASHT, pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaz dhe në shkollën profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente :

- Fletëparaqitjen, e cila do të merret në shkollën, në të cilën konkurron,
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9)
- Certifikatën e lindjes.

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Dorëzimi i dokumenteve për gjimnaz dhe shkollën profesionale për vitin shkollor 2019/2020 , bëhet me datat:24, 25, 26, qershor 2019 në lokalet e shkollës amë , ku nxënësi dëshiron të regjistrohet, duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve do të shpallen në shkollat përkatëse me datën **28.06.2019.**

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej **29.06.2019.**

Kandidati i refuzuar, i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit, dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT -it, te komisioni për ankesa.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriterë :

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar(25%) 25 pikë

2. Suksesi nga lëndët prioritare në test.....(15%) 15 pikë

3.Numri i pikëve nga testi.....(60%) 60 pikë

Nxënësi maksimum mund t'i fitojë 100 pikë

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaz është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4 (së pari gjindet mesatarja e lëndëve veç e veç, pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve)

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaz është minimum 40% i pikëve nga ato lëndë.

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl.6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 25 pikë .

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është :

$$\frac{\text{Suksesi (kl.6+kl.7+kl.8+kl.9)}}{4} \times 5 = 25 \text{ pikë maksimum}$$

2. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 15 pikë (p.sh. 3 lëndë të profilit të caktuar shumëzohen me mesataren e notave të kl.6-9 të $(5+5+5+5) = 20; 20:4=5$)

$$\frac{\text{Mesatarja e lëndës (I) + mesatarja e lëndës (II) + mesatarja e lëndës (III)}}{3} \times 3 = 15 \text{ pikë maks.}$$

Kur në profilin e caktuar kërkohen vetëm dy lëndë, në këtë rast vlera e fituar pjesëtohet me 2 dhe shumëzohet me 3 :

$$\frac{\text{Mesatarja e lëndës (1)+mesatarja e lëndës (II)}}{2} \times 3 = 15 \text{ pikë maksimum.}$$

Në rast se kemi pesë lëndë, prapë mblidhen mesataret e 5 lëndëve , pjesëtohen me 5 dhe shumëzohen me 3.

3.Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

- **Gjimnazi i shkencave natyrore :** mesatarja e lëndëve : fizikë, kimi dhe biologji së paku duhet të jetë 4(katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test, (10 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji).

p.sh: për 3 lëndë: $\frac{\text{kimi}(3)+\text{biologji}(4)+\text{fizikë}(5)}{3} = \frac{3+4+5}{3} = \frac{12}{3} = 4$

- **Gjimnazi i shkencave shoqërore :** Mesatarja e lëndëve gjuhë shqipe, gjuhë angleze, hystori, gjeografi dhe edukatë qytetare së paku duhet të jetë 4 (katër) si 40% të lëndëve prioritare në test (20 pikë nga lëndët gjuhë shqipe, gjuhë angleze, hystori dhe gjeografi)

Për 5 lëndë :

Mesatarja e gj. amtare + mes.gj.ang.+ mes.his+mes.gjeo.+mes.ed.qytetare X 3=15 pikë
5

B. Pëmbajtja e testit : numri i kërkesave (pyetjeve) sipas lëndëve

I.Gjuhë:

- | | |
|--------------------|---------|
| 1.Gjuhë shqipe | 20 pikë |
| 2.Gjuhë angleze | 5 pikë |
| (Gjithsej 25 pikë) | |

II.Shkencat shoqërore:

- | | |
|----------------------|---------|
| 1.Gjeografi | 12 pikë |
| 2.Hystori | 13 pikë |
| (Gjithsej 25 pikë) | |

III:Matematikë

- | | |
|----------------------|---------|
| 1.Matematikë | 20 pikë |
| 2.Informatikë | 5 pikë |
| (Gjithsej 25 pikë) | |

IV.Shkencat natyrore:

- | | |
|---------------------|--------|
| 1.Fizikë | 9 pikë |
| 2.Kimi | 8 pikë |
| 3.Biologji | 8 pikë |
| (Gjithsej 25 pkië) | |

4. Renditja e lëndëve me prioritetet sipas drejtimeve të gjimnazeve:

I. Gjimnazi shkencat e natyrës:

1. Shkencat e natyrës	25		25x1.2=30 pikë
2. Matematikë informatikë	25		25x0.6=15 pikë
3. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze	25		25x0.4=10 pikë
4. Shkencat shoqërore	25		25x0.2=5 pikë
			Totali 60 pikë

II. Gjimnazi shoqëror :

1. Gjuhë amtare, gjuhë angleze dhe shkencat e natyrës	50		50x0.9=45 pikë
2. Matematikë informatikë	25		25x0.4=10 pikë
3. Shkencat natyrore	25		25x0.2=5 pikë
			Totali 60 pikë

5. Rënditja e lëndëve me prioritetet sipas profileve në shkollën profesionale

I. Elektroteknikë dhe Kimi- Teknologji

1. Matematikë dhe informatikë	25		25x1.2=30 pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze	25		25x0.6=15 pikë
3. Shkencat natyrore	25		25x0.4=10 pikë
4. Shkencat shoqërore	25		25x0.2=5 pikë
			Totali 60 pikë

II. Ekonomi (banka dhe financa , kontabilitet)

1. Matematikë dhe informatikë	25		25x1.2=30 pikë
2. Gjuhë amtare gjuhë angleze	25		25x0.6=15 pikë
3. Shkencat shoqërore	25		25x0.4=10 pikë
4. Shkencat natyrore	25		25x0.2=5 pikë
			Totali 60 pikë

Shkollat e Mesme të Larta

I. Gjimnazi “ 17 Shkurti “ në Obiliq

Nr.	Drejtimi	Numri i paraleleve	Numri i nxënësve
1.	GJIMNAZI NATYROR	2	64
2.	GJIMNAZI SHOQËROR	2	64
Gjithsej:		4	128

II. SHMLP “ Ismail Dumoshi“ në Obiliq

Nr.	Drejtimi	Profili	Nr.i paraleleve	Nr.i nxënësve	Vitet e shkolli mit
1.	ELEKTROTEKNIKË	ENERGJETIKË	2	64	2+1
		INFORMATIKË	1	32	2+1
2.	KIMI-TEKNOLOGJI	XEHTAR	1	32	2+1
3.	EKONOMI	BANKA DHE FINANCA	1	32	2+1
		KONTABILIST	1	32	2+1
Gjithsej			6	192	

UD :Rexhep Zeka

